Broshurë teknike

# ISOMAT PROFESSIONAL ACRYL

## Bojë akrilike cilësie të lartë për përdorim the jashtëm, ideale për profesionistë

### Përshkrimi

ISOMAT PROFESSIONAL  ACRYL përdoret për sipërfaqe të reja dhe të vjetra, të cilat kërkojne lyerje të shpeshtë si ndërtesa publike, hotele, shkolla, si dhe sipërfaqe që kanë humbur shkëlqimin nga graffiti. Karakterizohet për punueshmërinë e mire dhe mbulimin e sipërfaqes, si dhe rezistenca e lartë ndaj vjetërsisë. Thahet shpejt, kështu që mund të rivishet shpejt.

### Fushat e përdorimit

ISOMAT PROFESSIONAL ACRYL përdoret në ambiente të jashtme ose të brendshme, në sipërfaqe të reja ose të vjetra, mbi sipërfaqe si beton, suva, tulla, pllaka gipsi, çimento asbesti, dru, etj.
Është ideale për profesionistët si një zgjidhje ekonomike dhe e sigurtë për lyerjen.

### Të dhënat teknike

| | |
|---|---|
| Ngjyra: | e bardhë dhe 1423 ngjyra të zgjedhura (ISOMAT COLOR SYSTEM) |
| Trajta: | 100% emulsion akrilik boje |
| Densiteti: | 1.47 kg/litër |
| pH: | 8-9 në +23$^0$C |
| Mbulimi: | min 97% |
| Bardhësia: | min 87% |
| Pasqyrimi diellor (SR): (ASTM E903-96) | 87% |
| Rrezatimi infrakuq: (ASTM C1371-04a) | 0, 89 |
| Koeficienti i pasqyrimit diellor (SRI): (ASTM E1980-0) | 110 |
| Thithja kapilare e ujit: | 0.08 kg/m$^2$h$^{0,5}$ |
| Forca njgitëse: | 1.80 N/mm$^2$ |
| Viskoziteti (Poise): | 11-16 |
| Koha e rilyerjes: | 3-4 orë |

Pastrimi i veglave:
Hiqni sa më shumë boje të jetë e mundur nga veglat e përdorura, para se të pastrohen. Pastroni veglat menjëhere mbas përdorimit me ujë dhe pastrues.

### Mënyra e përdorimit

**1. Nënshtresa**
Nënshtresa duhet të jetë e thatë, pa vaj, materiale të lira, pluhur, etj.

- Plasaritjet ose bashkimet mund të mbushen me mastikën akrilike ISOMASTIC-A.
- Difektet në beton duhet të riparohen me llaçin e modifikuar me polimer DUROCRET dhe në betoni i ekspozuar me stukon e modifikuar me polimer PLANFIX os PLANFIX-FINE.
- Regullimet e suvasë ne muret mund të bëhen me llaçet e parapërzier UNICRET dhe UNICRET-FAST.

Vazhdohet duke astaruar me astarin akrilik prej silikoni me bazë uji dhe të mikronizuar PRIMER ACRYL, të holluar deri 50% me ujë të pastër ose me astarin akrilik me tretës PRIMER ACRYL-S të holluar deri 100% me SM-18 ose me WHITE SPIRIT. Këto astare janë gjithashtu idealë për stabilizimin e sipërfaqes kur nënshtresa nuk është në gjëndje të mirë ose është e thërrmueshme.

**2. Zbatimi**
Para përdorimit, materiali përziehet lehtë dhe aplikohet siç është ose i holluar 5-10% me ujë të pastër. Dy shtresat të ISOMAT PROFESSIONALACRYL aplikohen duke përdorur ryl, furçë ose pistoletë airless. Shtresa e dytë aplikohet mbasi është tharë krejt shtresa e parë. Temperatura gjatë

aplikimit dhe tharjes të bojës duhet të jetë ndërmjet 10°C and 35°C.

## Konsumi

ISOMAT PROFESSIONAL ACRYL mbulon 12 $m^2/l$ për shtresë, në sipërfaqë të parapregatitura.

## Amballazhimi

ISOMAT PROFESSIONAL ACRYL ofrohet në bidona plastike prej 0,75, 3 dhe 9 litrash.

## Magazinimi

Të paktën 24 muaj nga data e prodhimit në thasë të mbyllur, në temperatura ndërmjet +5°C dhe +35°C dhe në vende të mbrojtura nga rezet e diellit dhe ngrica.

## Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)

Sipas Direktivës 2004/42/CE (Shtojca II, tabela A), përmbajta maksimale e lejuar e VOC-së për përoduktin e nënkategorisë "c", lloji WB është 40g/l (2010) për produktin e gatshëm për përdorim.

Produkti i gatshëm për përdorim ISOMAT PROFESSIONAL ACRYL përmban maksimum 40 g/l VOC.

CE

**2032**

**ISOMAT S.A.**
**17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios**
**P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece**

**16**

2032-CPR-10.11

DoP No.: ISOMAT PROFESSIONAL ACRYL / 1427-03

**EN 1504-2**

Surface protection products

Coating

Permeability to $CO_2$: Sd > 50m

Water vapor permeability: Class I (permeable)

Capillary absorption: w < 0.1 $kg/m^2 \cdot h^{0.5}$

Adhesion: ≥ 1.0 $N/mm^2$

Artificial weathering: Passes

Dangerous substances comply with 5.3

**ISOMAT S.A.**
BUILDING CHEMICALS AND MORTARS
**ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:**
17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475
**www.isomat.eu e-mail: info@isomat.eu**

Informacioni teknik dhe udhëzimet e dhëna në këtë fletë të dhënash bazohen në njohurinë dhe në përvojën e Departamentit të Kërkimit dhe të Zhvillimit të kompanisë sonë dhe në rezultatet e dala nga përdorimet afatgjata të produktit në praktikë. Rekomandimet dhe sugjerimet që i referohen përdorimit të produktit jepen pa garanci, meqenëse kushtet e terreneve gjatë përdorimeve të tij janë përtej mundësisë së kontrollit të kompanisë sonë. Si rrjedhojë, përdoruesi është përgjegjës për të konfirmuar se produkti i zgjedhur është i përshtatshëm për përdorimin e parashikuar. Botimi aktual i kësaj flete të dhënash teknike anulon automatikisht çdo botim të kaluar që lidhet me të njëjtin produkt.

TÜV CERT EN ISO 9001